



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 79/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani, duke vendosur përkitazi për ankesën e Shkelzen Jusaj në cilësinë e kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Shkelzen Jusaj në cilësinë e kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.01.2011, nga Shkelzen Jusaj në cilësinë e kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik AAK, me te cilën pretendohet se në Irzniq komuna e Deçanit, pa dy klasë të numëruara kishte 385 vota, ndërsa në proces i janë regjistruar vetëm 188 vota, shkeljet më të mëdha janë paraqitur kryesisht në klasën nr.4. Në fshatin Strelle komuna e Deçanit sipas shënimeve të vëzhguesve kishte 475 vota, ju kanë evidentuar 452 vota, ndërsa në fshatin Lumbardhë ka pasur 178 vota, ju kanë evidentuar 175 vota. Gjithmonë sipas komisioneve ka shkelje të rënda gjatë numërimit në Gramaqel, Carrabeg, Isniq, Drenoc dhe Deçan. Sipas parashtruesit të ankesave votat e keqpërdorura kryesisht i ka përfituar kandidati i AAK-së me nr.49. më këtë parashtruesi i ankesës kërkon rinumërimin e kutive të votimit në komunën e Deçanit.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizo shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lentes rrjedh se pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkak se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se kanë ndodhur shkeljet e tilla. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 79/2011 më datën 13.01.2011

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

